



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KUVENDI

*Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës
ndaj Gruas*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.04.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Eglantina Gjermeni – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës Kundër Dhunës, të miratuar nga Kuvendi (për periudhën prill – korrik 2018 dhe (draft) shtator – dhjetor 2018).
2. Miratimi i kalendarit të punës së nënkomisionit.

Marrin pjesë:

Eglantina Gjermeni, Elona Gjebrea, Klodiana Spahiu, Musa Ulqini, Floida Kërpaçi dhe Antoneta Dhima.

Mungojnë:

Orjola Pampuri, Rudina Hajdari dhe Fatbardha Kadiu.

HAPET MBLEDHJA

Eglantina Gjermeni – Mirëdita dhe mirë se erdhët!

Faleminderit që jeni këtu për mbledhjen e Nënkomisionit!

Siç jeni njoftuar nga sekretaria, takimi i sotëm është për të vendosur një kalendar pune, takimesh, por edhe për të diskutuar, pasuruar dhe, si të thuash, finalizuar një plan veprimi për Rezolutën Kundër Dhunës.

Meqenëse Nënkomisioni për Barazi Gjimore dhe për Parandalimin e Dhunës është krijuar direkt si rezultat i miratimit të kësaj rezolute, plani ynë i veprimit është zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të kësaj rezolute për të gjithë parlamentin.

Unë kam bërë një draftplan veprimi për ta pasur si orientim, mbi bazën e të cilit të diskutojmë, duke iu referuar të gjitha angazhimeve që ka parlamenti sipas kësaj rezolute. Sigurisht që mund të kem harruar ndonjë gjë, ka vend për të shtuar, përmirësuar ose ndryshuar. Nuk janë me afat kohor duke ardhur në rrjedhë kronologjike, për shembull, në prill, maj, qershor, korrik e deri në dhjetor, por i kam grupuar sipas rëndësisë apo fushave tematike, duke theksuar në këtë draft se për sa u përket aktiviteteve, Nënkomisioni do të jetë në koordinim dhe bashkërendim të punës me Nënkomisionin e të Drejtave të Njeriut dhe Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore, me Aleancën e Grave Deputete dhe me Komisionin e Çështjeve Sociale. Veprimtaria jonë do të jetë e lidhur ngushtë edhe me veprimtarinë e këtyre aktorëve dhe e mirëkoordinuar me ta, duke dashur që mesazhi të jetë më i fortë dhe të japë një kontribut më të rëndësishëm.

Nga ky draftplan veprimi mund të nxjerrim aktivitete apo mbledhje që mund t'i bëjmë pjesë të kalendarit tonë. Mendoj të kemi një kalendar pune nga muaji prill, që, në fakt, po mbaron, deri në fund të majit, të dimë kur i kemi mbledhjet, çfarë takimesh do të kemi, dhe t'i japim pak intensitet kësaj pune, sepse në momentin e parë që u takuam kishim disa ide dhe sugjerime. Jam e bindur që kemi edhe shumë ide dhe sugjerime, që do t'i diskutojmë sot, por është momenti për t'i finalizuar dhe për të thënë mendimet dhe sugjerimet tona, që të miratojmë një kalendar pune dhe Nënkomisioni të jetë më aktiv.

Kërkoj ndjesë, sepse për shkak të asaj që më ka ndodhur, nuk kam mundur ta bënim mbledhjen më parë, por të mundohemi ta rikuperojmë këtë pjesë të kohës duke caktuar data dhe mbledhje konkrete tematike.

Faleminderit!

Mendoni të fillojmë me prezantimin e këtij draftplan veprimi dhe duke diskutuar të shikojmë afatet dhe të nxjerrim veprimtari apo takime për kalendarin e punës apo të fillojmë

me kalendarin e punës dhe më pas të shikojmë draftplanin e veprimit? Ky plan veprimi është deri në fund të vitit minimalisht, është shumë afatgjatë, do t'i shkojë Kryesisë së parlamentit dhe ndoshta edhe komisioneve të tjera, sepse, siç ka një plan veprimi për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, edhe për këtë rezolutë do të kemi një plan veprimi, do të monitorohemi për të dhe do të na udhëheqë në punën tonë.

Më thoni, si është më lehtë, të fillojmë me draftplanin e veprimit dhe më pas të vëmë kalendarin, apo do të japim ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, mund të dalim nga kjo, por mund të ketë ide dhe sugjerime të tjera, ndaj them.

T'i them shkurt ato që kam pasur në mendje këtu apo do t'i shikoni vetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, unë nuk lodhem, por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Elona Gjebrea – Mendoj se gjëja e parë që ne duhet të kemi përpara janë raportet se çfarë është bërë deri tani nga ministritë e linjës. Ju keni përmendur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Mendoj se duhet futur edhe Ministria e Drejtësisë për sa i përket ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e lexova.

Ndoshta do të ishte më mirë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

E kishe fjalën për Revaldin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, më falni, nuk e pashë.

Po i mbaroj këto të dyja që m'i kapi syri shpejt, se ndoshta duhet më shumë kohë.

Kam përshtypjen se te shoqëria civile do të biem dakord që do të jetë vetëm për qendrat që merren me menaxhimin e dhunës në familje. Për shembull, qendra e Vlorës. Nëse flasim për qendrën e Vatrës, merret me trafikimin, ndaj të mos i ngatërrojmë gjërat.

Qendra e Kazmës, për shembull, merret me dhunën në familje. Aty mund të ketë raste, por ne gjithmonë e kemi kritikuar këtë fakt, sepse kemi menduar që, për sa kohë ka qendra të trafikimit, të mos ngatërrohemi me qendrat e tjera, por sigurisht që ka edhe raste të dhunës që janë viktima të trafikimit. Nuk është e lehtë ta ndash këtë gjë.

Në këndvështrimin tim është më mirë që në fillim të marrim një listë të organizatave që ofrojnë shërbime të dhunës në familje dhe më pas edhe me viktima të tjera, që mund të jetë

trafikimi. Nuk e di nëse është përmendur këtu, meqenëse thuhet “me qendra të dhunës dhe jo vetëm”, sepse diku e pashë. Këto ishin komentet e mia të shpejta.

Eglantina Gjermani – Më fal, por e gjithë puna e Nënkomisionit tonë nuk është vetëm për dhunën, që të biem dakord paraprakisht, por është për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Kur flasim për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, flasim për të gjitha fushat. Në seancat dëgjimore që janë vënë në listë është fuqizimi ekonomik i grave, shërbimet dhe fushat e tjera, jo për t’i ngatërruar me njëra-tjetrën, por për të thënë se ne nuk jemi vetëm për dhunën. Edhe fuqizimi ekonomik i grave, si çështje më vete, edhe gratë e qendrave rurale është çështje më vete për seancat dëgjimore, OJF-të që punojnë aty. Secila do të ketë fokusin e vet. Ne nuk do të jemi vetëm për dhunën. Rezoluta është për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, është shumë më e gjerë sesa dhuna. Do t’i adresojmë çështjet pa i ngatërruar, sepse ne jemi të rritur, dimë ta kuptojmë, duke i adresuar çështje specifike të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore.

Floida Kërpaçi – Kjo është mbledhja ime e parë dhe dua t’ju falënderoj ju për këtë plan veprimi, që në një shikim të thjeshtë që i bëra, m’u duk shumë i mirë!

E mbështes idenë për të filluar me një plan të parë për të parë raportet ku jemi dhe më pas ne të ndërtojmë aktivitetin dhe axhendën tonë! Do të sugjeroja që këtë muaj, gjysmën ose gjithë muajin tjetër, se jemi në përfundim të muajit prill, të vazhdojmë me seancat dëgjimore, të krijojmë një listë të të gjitha organizatave, se cila nga ministrinë e linjës duhet të vijë. Pra, ta ndërtojmë sot kalendarin, të themi se në këtë datë kemi këtë seancë, në atë datë kemi atë seancë, të vendosim një ditë ku ne do të mbledhemi gjithmonë, që të mos e lëmë aktivitetin e Nënkomisionit si një moment spontan, si për shembull, javën tjetër kemi mbledhje dhe hajt se po diskutojmë këtë gjë, por të mendojmë se ne kemi mbledhje çdo javë, çdo javë do të kemi nga një çështje dhe në fund të çdo muaji ne do të krijojmë kalendarin tonë të aktivitetit gjatë muajit tjetër dhe gjithsecili prej nesh në komision të përgatitet, të angazhohet. Pra, nuk jemi në ndjenjën e spontanitetit. Unë e kam këtë merak, që të mos lindin probleme, për shembull, javën tjetër kemi mbledhje dhe do të diskutojmë këtë gjë. Të merremi seriozisht, të ndërtojmë draftin dhe planin tonë.

Siç tha edhe kolegja, unë do të propozoja të nisim me raportet, me seancat dëgjimore dhe në bazë të kësaj të ndërtojmë edhe draftin tonë, sepse do të na vijnë problematika, do të na vijnë shqetësime nga OJF të ndryshme dhe nga qytetarë, që mund të na bashkohen në dëgjuesat tona dhe të ndërtojmë një axhendë si për këtu, edhe për në terren. Për shembull, me gratë dhe vajzat në zonat rurale ne si deputetë mund të shkojmë aty dhe të zhvillojmë një seancë dëgjimore, që të jemi pranë komunitetit dhe t’i dëgjojmë. Pra, mund të kemi natyra të ndryshme si këtu në Kuvend, edhe jashtë, duke qenë pranë tyre.

Do të sugjeroja që edhe me strehëzat që punojnë me gratë dhe vajzat e dhunuara të mendojmë një mënyrë si do të funksionojë me to, sepse ne nuk shkojmë dot tek ato, por edhe nëse shkojmë, takimet do të jenë shumë diskrete, sepse, me aq informacion sa kam, nuk i dinë të gjitha vendet ku ndodhen ato. Duhet të mendojmë një mënyrë si të bashkëpunojmë me to, sepse kanë jashtëzakonisht shumë nevojë për t'u ndihmuar nga ne.

Ky do të ishte sugjerimi im për të filluar punën, duke ju falënderuar edhe një herë!

Antoneta Dhima – Në vijim të fjalës së kolegeve, mendoj se draftplani i veprimit i paraqitur nga ana juaj i ka përfshirë ministrinë përgjegjëse, pushtetin vendor, 61 bashkitë, shoqërinë civile dhe patjetër që pjesën e Kuvendit dhe pjesën e Aleancës së Grave Deputete. Mendoj se ne duhet të kalojmë në kalendarin e gjithë këtyre veprimtarive, sepse pak a shumë ne kemi përcaktuar kohën dhe muajin, por për të kaluar në detaje konkrete, sepse edhe pjesa e vizitës në strehëza, që kolegia tha, është parashikuar në këtë draft planeprimi. Në fakt, në kalendar do të jenë më të detajuara të gjitha këto veprimtari. Më parë ne kemi bërë edhe një takim, ku kemi thënë se, do të fillojmë të marrim një informacion për gjendjen se ku jemi. Këtë informacion ne do ta marrim nga seanca dëgjimore që ministrinë do të bëjnë me Nënkomisionin tonë. Nga ai moment kemi mundësinë që të planifikojmë të gjitha aktivitetet e tjera, të cilat do të jenë pjesë e kalendarit. Mendoj se drafti i ka përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse, si shoqërinë civile, ashtu edhe ministrinë dhe pushtetin vendor. Nuk mendoj se ne kemi ndonjë argument që mund të shtojmë gjëra të tjera te ky draft i planveprimit, kështu që, të kalojmë në kalendarin e punës së këtij Nënkomisioni.

Patjetër për ndonjë gjë, që mund të jetë e parashikuar apo nuk është e parashikuar siç duhet, kemi mundësi ta korrigjojmë në vazhdimësi. Nuk është e nevojshme që ne të harxhojmë kohën te drafti i planveprimit, sepse është i plotë, prandaj të kalojmë direkt te kalendarin, që të diskutojmë, konkretisht këto që janë parashikuar te planveprimi dhe t'i detajojmë.

Faleminderit!

Elona Gjebrea – Ndoshta nuk ka nevojë ta përsërisim, por është vërtet një draft shumë i mirë, i cili do të na orientojë në punën tonë. Besoj se do ta ndihmojë Aleancën e Grave, që të ketë një bashkëpunim dhe jo përplasje. E vetmja gjë, dhe kërkoj ndjesë, sepse tani e pashë që është planifikuar në draftplan dhe seanca dëgjimore me ministren e Drejtësisë, nuk e di pse më kishte ikur nga vëmendja. Ndoshta jo tani shpejt, por thjesht për ta pasur në planin e punës një takim, për shembull, me përfaqësuesit e Komisionit Europian, apo ambasadorë, pra një takim miqësor, thjesht për t'u vënë në konsideratë. Nuk ka nevojë që të jetë shpejt e shpejt, por, pasi ne të kemi ecur me punën tonë, ndoshta mund ta bëni ju, si kryetare, sepse jo domosdoshmërisht mund të jetë i gjithë komisioni, por mendoj se është mirë që të informohen për punën që bëhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Floida Kërpaçi – Pas draftit dhe kalendarit që do të përcaktojmë, mund të lëmë një takim në ndonjë vend, ku të ftojme të gjithë ambasadorët ose kë mendojmë ne, dhe aty të bëjmë një prezantim. Pra, të jetë një gjë shumë miqësore, por ndërkohë të jetë edhe si prezantim, që ne si Nënkomision kemi ndërmarrë këtë draft, do të bëjmë këtë gjë, si mund të na mbështesni. Pra, pasi të bëjmë diçka, jo tani, por mund të lëmë diçka, sepse do të ishte një gjë shumë e mirë.

Musa Ulqini – E thashë në mbledhjen e kaluar që jam me fat, sepse do të mësoj shumë nga kjo fushë, pasi jam me disa që e njohin shumë mirë çështjen, e kam parë me shumë vëmendje, dhe urime!

Mendoj se kalendari për muajin maj është mjaft i goditur, sepse kemi një seancë dëgjimore me ministren, që ka qenë në një ngjarje shumë të rëndësishme, dhe kemi 5 materiale, dhe i fundit vjen nga 61 bashkitë, që janë shumë të rëndësishme për të krijuar në një pamje shumë të qartë për punën që do të bëjmë. Pra, mendoj se planifikimi është shumë i saktë. Ne kemi nevojë për dije, për informacion dhe këto 5 materiale që do të vijnë, që janë planifikuar për muajin maj janë të mira për secilin nga ne, pavarësisht nga këndvështrimet, angazhimet apo qëndrimet politike, sepse këtu ka shumë pak gjëra për të bërë politikë dhe shumë gjëra për të diskutuar bashkërisht. Pra, nuk jam vetëm unë, ju jeni më shumë të kompletuara dhe të informuara për çështjet, por e theksoj edhe një herë, këto 5 materiale që janë planifikuar për muajin maj, besoj se të gjithëve do të na krijojnë një... Vetëm se duhet t'i lexojmë dhe t'i studiojmë, jo thjesht t'i kemi. Kështu që e mendoj si një gjë shumë të mirë. Duket sikur është vetëm një seancë dëgjimore, por besoj se është e mjaftueshme, sepse janë 5 gjëra që do të na vijnë këtu, që do të kemi kemi nevojë t'i lexojmë. Mund të kemi vonesa në dërgimin e informacionit nga pushteti vendor, se do të ngjajë një gjë e çuditshme, sepse një pjesë nuk janë marrë, por ne do të këmbëngulim që 61 bashkitë të dërgojnë çdo material, do të këmbëngulim dhe besoj se e kemi autoritetin për ta bërë këtë gjë. Prandaj mendoj se është një gjë, që na e lehtëson shumë punën. Ky është propozimi im: një kalendar me 5 apo 6 çështje, pra një seancë dëgjimore, dhe 5 informacione janë të mjaftueshme për të filluar një punë serioze, mbi një bazë që është e rëndësishme, mbi bazën e njohjes së çështjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Te plani i veprimit të shtojmë diçka në lidhje me buxhetimin gjinor. Mendoj se mund të realizojmë një seancë dëgjimore se si jemi me buxhetimin gjinor në çdo ministri. Meqenëse ju keni planifikuar një seancë dëgjimore me qeverisjes vendore, që, në fakt, do të vijnë të raportojnë për mekanizmin e referimit të rasteve...

Eglantina Gjermeni – Nuk është seancë dëgjimore, është një letër që ia dërgojmë ne, sepse nuk i thërret dot bashkitë këtu, që të bëjnë seancë dëgjimore. Pra, është letër që e firmosim ne, bashkë me kryetarin e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore, zotin Bashkim Fino, për t'i dhënë më shumë peshë.

Klodiana Spahiu – Dakord, por këta do të na sjellin informacion?

Eglantina Gjermeni – Po.

Klodiana Spahiu – Do të ishte më mirë që qeverisja vendore të na sillte informacion në lidhje me buxhetimin gjinor, për të parë nëse janë angazhuar qeverisjet lokale në lidhje me mbështetjen e gruas, mbi të gjitha, ekonomikisht, por edhe në të gjitha aspektet e tjera. Nëse ju mendoni se ne do të bëjmë diçka shtesë, përveç dhunës ndaj gruas, por edhe për barazinë gjinore, që nënkupton përfshirjen ose forcimin ekonomik të gruas, pra të kemi një bashkëpunim.

Eglantina Gjermeni - Do të kemi një seancë dëgjimore për fuqizimin ekonomik për të drejtën e grave në tregun e punës.

Klodiana Spahiu – Në rregull, më fal, se nuk e kisha lexuar!

Meqenëse dhe UNDP-ja po bën një studim në lidhje me buletin gjinor, them se ne mund t'i paraprijmë kësaj gjëje në lidhje me buxhetimin gjinor në çdo ministri.

Elona Gjobrea – Për këtë që tha Klodi, për të qenë realist se çfarë ne mund të bëjmë brenda kësaj kohe, ndoshta informacionin për pjesën e buxhetimit gjinor, ne do t'ia kërkojmë çdo ministrie, ku mund ta përcaktojmë të detajuar raportin vjetor, përfshirë edhe buxhetimin gjinor. Çdo ministri e ka për detyrë këtë gjë, por të jemi realist asnjëherë nuk ka funksionuar, është më shumë informacion për ne dhe ndoshta për të lobuar ne në kohën e duhur, sikurse tha Klodi, për sa i përket vitit të ardhshëm.

Së dyti, meqenëse kam pasur disa lidhje të mëparshme për sa u përket disa strukturave parlamentare europiane, ata kanë kërkuar (Klodi, meqenëse bën pjesë në shëndetësi, ka qenë në shumë aktivitete vite më parë) që të vijnë në Shqipëri dhe mund të vendosim diçka nga qershori për të ardhur, ku të kemi mundësinë, që edhe ata të na tregojnë se çfarë bëhet në vendet e tjera. Këto mund të jenë edhe në vitin e ardhshëm, sepse ne duhet të jemi realistë, që jemi në prill, dhe ky është nënkomisioni dhe kemi edhe 3 vjet punë. Pra, është më mirë që gjërat t'i bëjmë avash, avash se sa të ngarkohemi më shumë. Për hir të së vërtetës, është një gjë perfekte, siç e shikoj unë, por thjesht të jemi pak realistë me afatet, duke menduar që ne të kemi kohë për t'i lexuar raportet që do të vijnë dhe të studiojmë pak dosjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, as unë nuk jam në gjendje ta them në kuptimin e shpejtësisë, por duke menduar se kjo është një gjë, që ne na përmbledh pak a shumë atë që ne duam të bëjmë, si nënkomision, në një afat kohor pak më të gjerë, ndoshta duke i mbyllur të gjitha deri në dhjetor, kam frikë se do të ngarkohemi shumë dhe më pas nuk do të jemi shumë inovatorë në aktivitetet që do të vijnë më pas. Megjithatë, ju keni eksperiencë më shumë, ju i dini në kuptimin edhe të shpejtësisë që vijnë nga institucionet në Kuvend dhe koha që ne na duhet. Kështu që si deputete e re ndoshta jam e fundit që duhet të flas në lidhje me këtë gjë, por e kam me merak.

Nga ana tjetër, e mirëkuptoj se ne duhet të ecim dhe të tregojmë se kemi bërë diçka. Vizitat mund të kombinohen shumë mirë që keni lënë periudhën korrik-dhjetor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, ne të gjitha jemi anëtare të Aleancës së Grave, kështu që, kjo është një gjë e mirë, që i vjen në ndihmë edhe kësaj strukture. Vetëm kaq mund të them në këtë moment. Ne jemi edhe në fazën që kemi bërë vetëm një mbledhje, nuk kemi ecur shumë, por, gjithsesi, shpresoj të realizohen në takimin e fundit, atë të majit, që të ecim me një planveprim dhe tani kemi se çfarë të marrim si orientim.

Eglantina Gjermani – Në fakt, ai draft i planveprimit është ambicioz, unë kështu di të punoj. Mbase është shumë ambicioz, por po nuk e realizuam deri në dhjetor, e vazhdojmë vitin tjetër, askush nuk na detyron. Mirë është të jemi realist, por jo të gjitha këto duan kohë për t'u mbledhur së bashku. Një pjesë e tyre janë letra, që i çoj unë, në cilësinë e kryetares, por patjetër duke ua bërë juve të ditur, që është e rëndësishme që të kërkojmë informacion për këtë gjë, që t'u kërkojmë njësive vendore këtë gjë, që t'i nxisim ato njësitë vendore, që nuk e kanë apo kërkojmë informacione, të cilat vijnë këtu dhe më pas do të mbledhemi për t'i realizuar. Në qoftë se vërtetë ka gjëra që janë më ambicioze seç duhet, sepse edhe për mua është hera e parë që drejtoj një nënkomision, hajdeni t'i heqim, jemi ne që e vendosim, askush nuk na detyron të themi se i pakësojmë, nuk kam asnjë problem.

Për sa i përket buxhetimit gjinor, në fakt, kur e shikoj fuqizimin ekonomik të gruas dhe tregut të punës, kam parashikuar në tetor 2018, thjesht aproksimative pa asnjë gjë në mendje, pa dyshim, ajo që tha Klodi për t'u kërkuar njësive vendore për buxhetimin gjinor punën që bëjnë, mbase na shkon më mirë para kësaj seance dëgjimore, që t'i marrim dhe ta ngremë si shqetësim, por nuk di sa do të jetë realist për buxhetin e vitit tjetër, aty dyshoj. Por në momentin që t'i çojmë për mekanizmat e dhunës, nuk dua t'i bëjmë konfuzë njësitë vendore edhe për faktin se një pjesë e njësive vendore, nga 30 e ca, i kanë ngritur mekanizmat kundër dhunës dhe po funksionojnë goxha mirë, ka të tjerë, është thjesht mungesë vullneti, që janë në proces ose se kanë filluar. Prandaj e kam shkruar aty, që i dua të personalizuar, duke ju thënë se nuk e keni

filluar, mendojmë se duhet ta filloni këtë gjë. Pra, ata që e kanë filluar mendoj se duhen vlerësuar. Si kryetare e nënkomisioni, mendoj se ka peshë. Meqenëse folëm për buxhetimin gjinor, dua t'ju vë në dijeni se jam në bisedime me *UN Women*. Ata duan të bëjnë një *workshop* me anëtarët e nënkomisionit tonë për buxhetimin gjinor me qëllim për të na ndihmuar dhe për të qenë proaktiv për pjesën e buxhetit. Nuk më kanë dhënë akoma afate, por vetëm si ide.

Ndërkohë, *UN Women* iu kërkua me shkesë nga mua që të sjellë botime për të gjithë anëtarët e nënkomisionit. Shkresa është dërguar pas mbledhjes së parë dhe tani presim të vijmë.

Ndërkohë, u kam kërkuar drejtuesve të Kuvendit të na vënë në dispozicion një zyrë të vogël për të zhvilluar mbledhjet e nënkomisionit dhe për të pasur botime. Ne nuk kemi ambiente ku t'i mbajmë raportet. Do të marrim raporte nga ministritë, por na duhet një ambient pune për t'i mbajtur. Në qoftë se na e siguron Kuvendi, kjo do të ishte gjë e mirë.

Për sa u përket seancave dëgjimore që janë menduar të bëhen, ato janë disa. Njëra nga ato është për gratë e moshuara. Data 1 tetor është dita e tyre, kurse dëgjuesat bëhen zakonisht afër asaj dite. Në kalendarin e punës unë e kam parashikuar për në korrik, në mënyrë që të mos kemi dëgjesa vetëm për dhunën, por edhe për gratë rurale dhe ato të moshës së tretë.

Ndërkohë, për sa u përket vizitave në terren, ju lutem jepni disa sugjerime. Aty janë draftuar vetëm si ide, por pa përcaktuar çfarë, kur, si, qysh, tek. Kështu që, kjo do të jetë në vazhdimësi.

E para është një nismë ligjore. Besoj se këtu na del neve detyrë si nënkomision për t'i nxitur komisionet, sepse ata e kanë më shumë nismën ligjore, dhe ministritë përkatëse për të marrë një nismë ndaj të gjitha formave të dhunës. Kjo është ambicioze, por super e domosdoshme. Jemi një nga shtetet që i mungon një ligj për këtë gjë.

E kam filluar me këtë duke menduar që, të paktën brenda mandatit tonë, t'i nxisim duke filluar me seanca dëgjimore, rekomandime dhe monitorime në mënyrë që vërtetë të fillojë puna për një projektligj të ri.

Gjithsesi, që të mos zgjatem, edhe pse Partia Demokratike nuk i ka sot përfaqësuesit këtu, sigurisht, ky draft u është dërguar me *e-mail*. Është subjekt ndryshimesh dhe diskutimesh dhe ne jemi ata që do ta përmirësojmë dhe ndryshojmë. Neve kemi një dokument mbi të cilin po punojmë, por, në momentin që na kërkohet, mund të mblidhemi sërish për të ndryshuar, përmirësuar apo sugjeruar diçka.

Meqenëse do të flasim konkretisht, më jepni ndonjë ide, përveç çuarjes së letrave, për periudhën prill-maj apo maj-qershor, që të lëmë tri çështje për diskutim. Letrat do t'i firmos dhe do t'i çoj unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. po.

Elona Gjebrea – Kam dëgjuar që në Kryeministri do të ngrihet një strukturë e koordinatorit kombëtar, por duhet verifikuar. Bile është diskutuar në nivel zëvendëskryeministri.

Kjo duhet sqaruar thjesht për të ditur që nëse ka struktura çfarë do të bëjnë për të pasur koordinim. Kjo mbetet për t'u verifikuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këndvështrimin tim, koordinatori kombëtar kundër dhunës në familje duhet ngritur, sepse do të na ndihmonte shumë. Për shembull, nëse do të ekzistonte, mund të vinte ai për të raportuar. Këto mund të jenë rekomandime që mund të dalin si punë e nënkomisionit.

E dyta, do të ishte mirë që ndoshta këta të *UN Women* të na japin një raport të fundit me një vështrim krahasues si është mekanizmi i dhunës në disa vende: një vend afër nesh, i cila ka të njëjtat problematika, një vend shumë i zhvilluar e të tjera. Mund të kërkojmë edhe vetë në internet, por meqenëse kemi luksin që ndërkombëtarët na mbështesin, mbase do të ishte mirë, që, në kërkesat e raporteve që ata sjellin, nëse e kanë këtë raport ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo krahasues. Në qoftë se kanë raporte, jam e bindur që ato bëjnë. Të gjitha i bëjnë këto. Kur flasim për Shqipërinë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë incizimi)

Eglantina Gjermani - Për bashkërendimin e punës për rastet e dhunës është edhe shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2017 për pjesën që i takon nënkomisionit.

E kanë sugjeruar Egla dhe Joana si pjesë e nënkomisionit. Kjo mund të jetë një ide për ta pasuruar. Ata bëjnë edhe për dhunën në familje në mënyrë eksplicite. Kanë sugjeruar edhe seancë dëgjimore me rastin e 15 majit, ditës ndërkombëtare të familjes. Mbase është sugjerim për çfarë mund të bëjnë gocat e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mendimin tim, jo domosdoshmërisht seancë dëgjimore, por diçka tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë, por disa seanca dëgjimore duhet të bëhen, sepse do na e lehtësonin punën për t'i çuar rekomandime institucioneve dhe për nxitje ministritë për të marrë nisma ligjore, sepse pa ato ne vetë nuk e bëjmë dot institucionalisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do të bëjmë në maj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Edhe këtu e kam një kërkesë për të dërguar materiale më përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkesa është më poshtë. Kështu që, do t'i bëjmë kërkesë që të na sjellin një material paraprak para se të vijë ministrja. Kjo është e para.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pastaj lëmë takimin.

Goca, do të koordinoni me kabinetin e ministres për një datë të mundshme. Kini parasysh që ne jemi në dispozicion të martave ose të mërkurave, por gjatë kohës së drekës pasi të kemi mbaruar komisionet e tjera.

A keni ndonjë ide më të mirë për familjen sesa thjesht seancë dëgjimore? Të mos bëjmë seancë dëgjimore, por një gjë ndryshe.

Unë jam takuar me shefin e UNIFEM-it dhe po diskutoj me të për të gjetur mënyra dhe mundësi për të asistuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata e kanë ndryshuar tani. Japin vetëm ...

Do jepni ndonjë ide deri në fund të javës apo për një javë se çfarë mund të bëjmë për ditën e familjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, këtë po them.

Edhe herën e kaluar thamë që do të japim ide, por nuk mblidhemi më, sepse të gjithë kemi superngarkesë. Megjithatë, për një javë maksimumi... Do t'i kujtosh ti, Joana! Ndërkohë, ide mund të japë edhe grupi i PD-së, pavarësisht se nuk ishin sot këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos bëjmë seancë dëgjimore, por diçka tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, shikojmë në internet çfarë aktivitete bëhen për ditën e familjes dhe pastaj i sugjerojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është e vërtetë.

Unë mendova diçka për Strehëzën Shtetërore të Grave të Dënuara, por nuk dua ta lidh me ditën e familjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, por, realisht, vizitën te ... Edhe ti do të kontribuosh në mënyrën tënde te kjo që do të them tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo nuk e kisha për ... Nuk e lidh me këtë.

Nuk mendova të shkojmë te strehëza thjesht ne deputetët për qokë dhe të ikim, por që të blejmë disa gjëra, ta bëjmë drekën bashkë, të hamë aty, të japim një mesazh tjetër. Jo thjesht ta shikojmë dhe pastaj mirupafshim. Ta bëjmë pak më të ngrohtë. Ata nuk kanë takuar ndonjëherë deputetë, por ta bëjmë ndryshe në mënyrën tonë. Për ditën e familjes nuk kam ndonjë ide, kurse për strehëzën kisha menduar ta bënim ndryshe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi gjë tjetër për në maj?

Rastësisht mora vesh që Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme bën raportime për SIDOU-n, prandaj t'u kërkojmë edhe atyre që të na dërgojnë informacione.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, por nuk e dija që e bënin tani këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk dija periudhën, sepse që e bëjnë ata e di. Mbase te Komisioni i Çështjeve Sociale vjen, por unë nuk e dija që tani është periudha që e bën Ministria e Jashtme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për SIDOU-n

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi gjë tjetër për muajin maj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto gjëra më shumë ia kam vënë vetes dhe gocave si detyra shtëpie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, e kam parasysh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E mbaj mend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të na ftojnë, pastaj ne vendosim si, qysh, tek. Bashkia Përrenjas më ka çuar një ftesë për në datën 24 prill më duket, sepse Bashkimi European do të bëjë diçka interesante me njësitë vendore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë fjalinë e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë e bukur, por hajde ta gjesh këtu për ta kombinuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe kjo qenka shumë interesante.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mendojmë, por mua më pëlqen ideja. Nuk e gjej dot çfarë konkretisht. Do ta mbyllim mbledhjen formalisht. Parimisht ramë dakord që draft-plani i veprimit, në qoftë se na kërkohet, është i miratuar nga ne, por mund të jetë subjekt ndryshimi, përmirësimi, rregullimi për afatet kohore apo për diçka tjetër. Kalendarin do ta shikoj me këshilltaret e komisionit sipas kësaj gjëje. Mund të na duhet ndihma dhe kontributi i secilit për letrat, sepse letrat që do të bëhen për të gjitha institucionet dhe 61 bashkitë secila më vete, kërkojmë asistencë.

Gocat e komisionit do të rakordojnë me stafin e ministres për të vendosur një datë paraprake. E para, t'i dërgojmë kërkesën me firmën time për të na çuar informacion paraprak dhe e dyta, për datën e mundshme. Ju falënderoj të gjithëve dhe uroj të takohemi shumë shpejt!

Sapo të koordinojmë me ministren.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA